



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.22.1-2018-08

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR MINISTRINË E ZHVILLIMIT
EKONOMIK**

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

Prishtinë, Maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Ministritsë së Zhvillimit Ekonomik*, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm z. *Qerkin Morina*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Muhamet Balaj* – udhëheqës i ekipit, *Qëndresa Sogojeva* dhe *Lumturije Sopi* - anëtare, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Blerim Kabashi*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	20
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	29
Shtojca II: Komentet e MZHE-së në gjetjet e raportit të auditimit.....	32

Përmbledhje e përgjithshme

Ky raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 25.10.2018

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se: Mallrat dhe shërbimet janë mbivlerësuar për 379,941€ dhe investimet kapitale për 69,501€. Gjithashtu, në regjistrin kontabël të pasurisë janë regjistruar pasuri me vlerë 512,372€ të cilat për nga natyra janë mallra dhe shërbime, ndërsa vlera e pasurisë si investime në vijim prej 335,588€ nuk është regjistruar në regjistrin e pasurisë.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Opinionit - Theksimi i çështjes pasqyron dobësitë në kontrole për shkak se nuk konfirmon klasifikimin e duhur të shpenzimeve dhe plotësinë e regjistrimit të pasurisë.



Ministri duhet të ndërmerë veprime për përmirësimin e kontroleve në mënyrë që raportimi i shpenzimeve në PVF të bëhet në mënyrë të drejtë (Shih nënkapitullin 2.1)

Dobësi të vazhdueshme janë vërejtur në menaxhimin financiar dhe kontrollet që ndërlidhen me pagat, prokurimin, shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, subvencionet dhe transferet kapitale për ndërmarrjet publike.



Ministri duhet të merr veprime të menjëhershme për vendosjen e kontroleve adekuata lidhur me fushat ku janë identifikuar dobësitë. (Shih nënkapitujt 2.4.1 - 2.4.4)

Ministria nuk ka adresuar plotësisht rekomandimet për vitin paraprak, dhe përmirësimet në fushat ku janë dhënë rekomandimet kanë qenë të ngadalshme.



Ministri duhet të zbatojë një proces me rigoroz për të siguruar që plani i veprimit për rekomandimet e vitit paraprak zbatohet në mënyrë aktive dhe çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit (Shih kapitullin 4).

NJAB nuk ishte sa duhet funksionale, planin e punës e kishte realizuar vetëm 67% dhe atë në fund të vitit. Auditimet nuk kanë kontribuar dhe ndihmuar menaxhmentin në parandalimin e parregullive.



Ministri duhet të sigurojë se do të funksionalizohet plotësisht NJAB dhe të sigurojë llogaridhënie dhe qeverisje adekuata në fushat e përcjellura me dobësi brenda organizatës. (Shih nën-kapitullin 5.1 dhe 5.2)

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Ministri nuk është pajtuar me të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e auditimit. Komentet e Ministrit për çështjet që nuk jemi pajtuar, janë dhënë në detaje në Shtojcën II.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar dhe se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësi dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për çështjet si vijojnë:

- Fondet për projektin "Sistemi i Integruar Informativ për Zhvillimin Ekonomik të Kosovës (SIIZHEK)", prej 379,941€ ishin buxhetuar dhe paguar nga kategoria mallra dhe shërbime, ndërkaq është dashtë të buxhetohen dhe të paguhen nga investimet kapitale. Pra, ekziston një mbivlerësim i shpenzimeve për mallra dhe shërbime, dhe rrjedhimisht, nënvlerësim i shpenzimeve për investime kapitale;

- Projekti “Prurjet vjetore të Inerteve në lumenjtë e Kosovës” prej 69,501€ ishte buxhatuar nga kategoria investime kapitale, ndërsa është dashtë të buxhetohet dhe paguhet nga kategoria mallra dhe shërbime. Pagesat e kryera, për të njëjtën shumë, paraqesin mbivlerësim të investimeve kapitale dhe nënvlerësim të shpenzimeve për mallra dhe shërbime. Sipas standardit ndërkombëtar të kontabilitetit nr. 38¹ për pasuritë e paprekshme – shpenzimet e hulumtimit, studimit apo kërkimeve nuk kapitalizohen dhe nuk njihen si pasuri e paprekshme, por ato duhet të klasifikohen si shpenzime operative;
- Në regjistrin e pasurisë kapitale në saldon fillestare janë identifikuar pesëmbëdhjetë (15) asete me vlerë neto prej 512,372€ të cilat për nga natyra takojn kategoris mallra dhe shërbime. Për të njëjtën vlerë janë mbivlerësuar pasuritë kapitale të ministrisë; dhe
- Ministria kishte investuar në dy shkolla në Gjakovë në kuadër të projektit “Zbatimi i masave të efijencës së energjisë në ndërtesa e shërbimit publik, dhe në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik “projektin e efijences se energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme” në fushën e shëndetësisë me vlerë totale prej 335,588€. Këto investime nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurisë kapitale në MZHE si investime në vijim, dhe nuk ishin transferuar tek organizatat që i shfrytëzojnë këto pasuri.

Çështjet kyçe të auditimit

- Ministria e Zhvillimit Ekonomik nuk ka azhurnuar regjistrin e E-pasurisë sipas rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në të cilin ende figurojnë pasuri kapitale në vlerë prej 1,500,000€, të cilat është dashtë të regjistrohen në SIMFK tek moduli i pasurive. Po ashtu, zhvlerësimi i pasurisë jokapitale në E-pasuri nuk ishte bërë për vitin 2018.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

¹ Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit nr. 38: “Të gjitha shpenzimet e studimit/hulumtimit duhet të klasifikohen si shpenzime operative dhe nuk duhet të kapitalizohen për arsye se është e pamundur të tregohet nëse do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen”.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalsjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Ministria e Zhvillimit Ekonomik kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë në shqyrtim përmbushjen e kërkesave si më poshtë:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 për Shpenzimi e Parasë Publike dhe Rregulloren nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive Jo Financiare në OB; dhe Rregulla nr. 02/2013 për Raportimin e Obligimeve të Papaguara të OB-ve;
- Ligjin e Buxhetit nr. 06/L-020 për vitin 2018;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Dorëzimin e planit të prokurimit sipas kërkesave të LPP.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I MZHE

Në PFV ishin të nevojshme disa korrigjime financiare për të cilat kemi dhënë sugjerime për të përmirësuar cilësinë e tyre, si në vijim:

- Në Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme sipas kërkesave të nenit 13, në kolonën e vitit 2017 të PFV-ve, Ministria kishte prezantuar grantin qeveritar në shumën prej 20,567,000€, ndërsa do duhej të prezantohej 20,223,000€; dhe
- Në nenin 18 të PFV-ve, ministria nuk i kishte prezantuar në mënyrë tabelare dhe me vlera financiare detyrimet kontingjente.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, përveç çështjeve të përmendura, mund të konsiderohet e saktë.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi B1 Ministri duhet të ndërmerr veprime për t'i forcuar kontrollet parandaluese në mënyrë që të shmangen rastet për Theksim të Çështjes në Opinion. Ne rekomandojmë që qysh në fazën e planifikimeve buxhetore, projektet të buxhetohen sipas kategorive ekonomike dhe klasifikimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë nëpër kodet adekuate.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të siguroj funksionimin adekuat dhe sistematik të kontrollit lidhur me plotësinë e regjistrave të pasurisë duke siguruar se Pasqyrat Financiare Vjetore do t'i nënshtrohen rishikimit dhe vlerësimit rigoroz nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, para se deklarata të nënshkruhet dhe PFV të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e shpenzimeve në organizatën buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar pjesërisht një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	24,405,435	23,660,348	22,447,006	22,972,556	29,011,107
Granti i Qeverisë -Buxheti	17,913,196	17,168,109	16,849,412	20,223,249	28,166,408
Financimet nga Huamarrjet	6,392,239	6,392,239	5,597,594	2,749,307	844,699
Klauzola e investimeve	100,000	100,000	0	0	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 3% apo 745,087€, ky ndryshim është rezultat i vendimit të Qeverisë nr. 04/82 në tremujorin e fundit të vitit, si shkak i tepricave buxhetore të ministrisë. Ministria ka treguar performancë të mirë në realizimin buxhetit, dhe shpenzimit në raport me buxhetin final, ishin gjithsej 22,447,006€ apo 95%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	24,405,435	23,660,348	22,447,006	22,972,556	29,011,107
Pagat dhe Mëditjet	1,176,686	1,293,195	1,293,195	1,116,910	1,073,641
Mallrat dhe Shërbimet	4,463,669	4,211,490	3,789,853	2,656,685	3,036,043
Shërbimet komunale	46,210	30,034	12,851	18,311	22,341
Subvencionet dhe Transferet	9,068,870	8,987,446	8,984,721	8,058,014	10,802,604
Investimet Kapitale	9,650,000	9,138,183	8,366,386	11,122,636	14,076,478

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

- Rritja e buxhetit final për paga dhe mëditje për 116,507€ është bërë në bazë të vendimeve të Qeverisë (nr. 02/70, nr. 02/76 dhe nr.07/80) për mbulimin e deficitit për shkak të rritjes së pagave të stafit politik si dhe numrit të zëvendësministrave në raport me planifikimin. Buxheti në këtë kategori është shpenzuar në tërësi - 100%.
- Krahasuar me buxhetin fillestar, buxheti final për mallra dhe shërbime është zvogëluar për 252,179€. Kjo, si rezultat i Vendimit të Qeverisë nr. 04/82 për kursime, ndarje, transfere dhe

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

rialokimeve ndërmjet kategorive të shpenzimeve të OB-ve për vitin 2018 ndërsa shpenzimi për këtë kategori është 90%.

Zvogëlimi i buxhetit final në komunalni për 35% apo 16,176€ është rezultat i vendimit të Qeverisë nr. 07/80 për kursime, ndarje, transfere dhe rialokimeve ndërmjet kategorive të shpenzimeve të OB-ve për vitin 2018 Përkundër zvogëlimit të buxhetit, shpenzimet në këtë kategori ishin vetëm 12,850€ apo 43%. Ulja shpenzimeve është si rezultat i bartjes së shpenzimeve të energjisë elektrike, për objektet qeveritare tek MAP si dhe mbulimi i shpenzimeve të energjisë elektrike për Aeroportin e Gjakovës nga vet NP "Aeroportit i Gjakovës" sh.a.

- Buxheti final për subvencione është zvogëluar në krahasim me atë fillestar për 81,424€ apo 1%, me vendime të Qeverisë (nr.12/67, nr.11/79 dhe nr.04/82) për shkak të kursime, ndarjeve, transfere dhe rialokimeve ndërmjet kategorive të shpenzimeve të OB-ve për vitin 2018 , ndërsa është shpenzuar 100%.

Buxheti final për investimet kapitale është zvogëluar për 5% apo 511,817€, që është rezultat i vendimeve të Qeverisë (nr. 07/80 dhe nr. 04/82) për shkak të kursimeve buxhetore. Realizmi i buxhetit në këtë kategori ishte 92%.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti për kategorinë paga dhe mëditje në vitin 2018 ishte në vlerë 1,293,195€, buxhet i cili ishte shpenzuar në tërësi (100%). Pagat menaxhohen dhe paguhen përmes një sistemi të centralizuar që administrohet nga MF.

Ne testuam edhe menaxhimin e proceseve në aspektin e pajtueshmërisë sa i përket menaxhimit të aktiviteteve në fushën e personelit, dhe identifikuam këto çështje:

Çështja A1 - Kompensim për punëtorët që nuk kanë punuar

Gjetja

Rregullorja Nr. 05/2010 e orarit të punës në shërbimin civil, neni 7 pika 1 përcakton se " gjatë orarit të punës të gjithë nëpunësit civil janë të obliguar të jenë në vendin e punës, çdo nëpunës civil shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik" dhe pika 2 thekson se " mospërfillja e orarit të punës paraqet shkelje disiplinore".

Sipas vendimit të Qeverisë nr.06/39 i datës 22.07.2015, të bazuar në marrëveshjen e Brukselit, për shuarjen e të ashtuquajturës "mbrojtja civile" në veriun e Mitrovicës, ministria ka qenë e obliguar t'i sistemoj 18 punëtorë të komunitetit serb me qëllim të integritit të tyre në sistemin e Republikës së Kosovës.

Marrëdhënia e punës për tetëmbëdhjete (18) zyrtarët është formalizuar në vitin 2016, në departamentin për integritet evropian, si zyrtarë për monitorim të zhvillimit ekonomik në nivel lokal. Ne nuk kemi asnjë dëshmi për realizimin/kryerjen e punëve në përputhje me përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi që janë ngarkuar në MZHE. Këta punonjës, gjatë vitit 2018, nuk ishin paraqitur në vendin e punës dhe nuk kishin kryer detyrat e përcaktuara me kontratë, ndërsa për pagat e tyre janë paguar 92,336€. Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mosrespektimit të kontratës në mënyrë të njëanshme nga ana e punëtorëve dhe përpjekjeve të pamjaftueshme të ministrisë për t'i angazhuar.

Rreziku Pagesa e pagave pa vijueshmëri në punë, shkakton dëmtim buxheti si dhe mos arritje të objektivave të përcaktuara me marrëveshje, pra integrimin e këtij komuniteti në sistemin e Republikës së Kosovës.

Rekomandimi A1 Ministri duhet që të shqyrtoj arsyet e mosvijimit në punë të këtyre punëtorëve, të zgjidhë problemin e angazhimit të tyre të rregullt në punë, ose në të kundërtën, të ndërpres pagesat e pagave të tyre të parregullta. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, ministri rekomandohet çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2018 ishte 4,211,490€, prej tyre ishin shpenzuar 3,789,853€ apo 90%. Ato kanë të bëjnë me shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse, shërbimet kontraktuese tjera, shpenzimet e udhëtimit zyrtar dhe drekat zyrtare.

Ne testuam edhe menaxhimin e proceseve në aspektin e pajtueshmërisë sa i përket menaxhimit të aktiviteteve në këtë kategori, dhe identifikuam këto çështje:

Çështja A2 - Mos shfrytëzimi i kontratës së Autoritetit Qendror të Prokurimit

Gjetja Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 05/2016 për zbatimin e procedurave të prokurimit qendror, neni 2 përcakton se dispozitat e këtij udhëzimi janë të detyrueshme për të gjitha institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës që marrin pjesë në procedurat qendrore të prokurimit publik.

Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) ka zhvilluar procedurat e prokurimit dhe me datën 27.02.2018 ka lidhur kontratë për "*Shfrytëzimin e fotokopjeve dhe printerëve me qira*" në emër të organizatave buxhetore. Në mesin e organizatave të cilat duhet të shfrytëzojnë këtë kontratë, ishte edhe MZHE. Ministria nuk kishte përdorur këtë kontratë, dhe për të përmbushur nevojat e saj, kishte blerë pajisje si: skaner, printer dhe tonerë në vlerë 35,586€. Këto blerje ishin bërë në kuadër të kontratës së MZHE "*Furnizimi me pajisje të teknologjisë së informacionit për shkollat të mesme "Qendra - Kreative"*".

Kjo kishte ndodhur pasi që Ministria ka konstatuar se blerja e pajisjeve është me e favorshme së shfrytëzimi i kontratës së AQP-së, mirëpo neve nuk na është ofruar dëshmia e llogaritjeve, respektivisht ndonjë analizë e kostove dhe përfitimeve.

Rreziku Anashkalimi i kontratës së AQP-së mund të ketë për pasojë furnizimet e Ministrisë me artikuj më të shtrenjtë sesa blerjet e kontraktuara në sasi të mëdha nga AQP.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të veprojë në pajtim me obligimet ndaj kontratave të AQP-së, me qëllim të ekonomizimit të shpenzimeve dhe arritjes së vlerës për para.

Çështja A3 - Pagesë e udhëtimit për qëllime jo zyrtare

Gjetja Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 2004/07 për shpenzimet e udhëtimit zyrtarë jashtë vendit, neni 2 përcakton se udhëtimet zyrtare nënkupton udhëtimet të cilat kanë një destinacion apo qëllim i cili shërben për kryerjen e detyrave zyrtare në interes të Qeverisë së Kosovës dhe të shërbimit civil të Kosovës.

Ne kemi identifikuar një rast ku ministria ka aprovuar dhe paguar vlerën 538€ për ushqim dhe akomodim, në emër të shpenzimeve për udhëtim zyrtar për ceremoninë e diplomimit/përfundimin e programit të masterit në Angli, ndërsa ky udhëtim është jashtë detyrave dhe qëllimeve zyrtare. Kjo ka ndodhur si rezultat i neglizhencës për të respektuar kërkesat ligjore.

Rreziku Shpenzimet për udhëtime jo zyrtare janë në kundërshtim me ligjin dhe paraqesin dëmtim të buxhetit të ministrisë.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të siguroj respektimin e rregullave në fuqi që shpenzimet për udhëtime zyrtare të bëhen vetëm për qëllime zyrtare dhe për të gjitha shpenzimet e pa rregullta, të bëhet kthimi i mjeteve në buxhetin e ministrisë.

Çështja A4 - Furnizim jashtë kontratës bazë

Gjetja Sipas neni 35 të Ligjit Prokurimit Publik (LPP) procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, pika 2.2 përcakton se autoriteti kontraktues për furnizime mund të lidhë kontratë të negociuar pa publikim: (i) për dërgesa shtesë nga furnizuesit fillestar kur dërgesat e tilla shtesë janë zëvendësime, me kusht që shtesa nuk është më e madhe se dhjetë përqind (10%) e vlerës së kontratës që mbulonte dërgesat fillestare.

Ministria përveç kontratës bazë “Furnizimi me pajisje të teknologjisë së informacionit për shkolla të mesme Qendra – Kreative” - Lot 1”, në vlerë 569,791€, kishte lidhur edhe aneks kontratë në vlerë prej 26,559€ për furnizime me pesë (5) skanerë dhe pesëdhjeteshtatë (57) tonerë të cilat nuk janë pjesë e kontratës bazë dhe as zëvendësime, por për këto blerje ministria duhej të zhvillonte aktivitet të ri të prokurimit. Kjo kishte ndodhur në mungesë të përgjegjësisë dhe kompetencës së personave përgjegjës.

Rreziku Furnizimet jashtë kontratës bazë janë në kundërshtim me ligjin në fuqi dhe rrisin rrezikun e shfrytëzimit të drejtë dhe efikas të fondeve publike, duke eliminuar konkurrencën dhe ulur transparencën në menaxhimin e buxhetit.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të siguroj se zyrtarët e prokurimit janë plotësisht përgjegjës dhe kompetent në punën e tyre, dhe se të gjitha blerjet bëhen në pajtim me procedurat, duke synuar çmime sa më konkurruese.

3.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 8,987,446€, fonde të cilat pothuajse ishin shpenzuar maksimalisht - 8,984,721€. Këto kanë të bëjnë me transferet për projekte kapitale për ndërmarrjet publike, subvencionet për ndërmarrje publike për mbulimin e shpenzimeve operative dhe grante për OJQ.

Ne testuam edhe menaxhimin e proceseve në aspektin e pajtueshmërisë sa i përket menaxhimit të aktiviteteve në këtë kategori, dhe në një rast Ndërmarrja Trepça me datën 09.02.2018 kishte lidhur kontratë për “Furnizim me goma për makina ngarkuese dhe transportuese të Minierës në Stantërg”, në vlerë 30,693€. Kompania kishte bërë furnizimin me 29 ditë vonesë dhe menaxherja e prokurimit, për shkak të vonesave, kishte kalkuluar ndëshkimet në shumën prej 2,993€. Ministria kishte bërë pagesën e plotë sipas kontratës bazuar në faturën e operatorit ekonomik dhe kërkesën nga departamenti i financave të NP Trepça, duke mos respektuar vendimin për aplikim të ndëshkimeve. Pas gjetjes tonë ministria ka ndërmarrë masa duke e bërë ndalesën në pagesën e radhës të datës 21.12.2018.

Çështja A5- Mos arsyetimi i subvencioneve sipas kritereve të marrëveshjes

Gjetja Marrëveshja për monitorim dhe kontrollë, neni 5, pika 10, në mes Ministrisë dhe Ndërmarrjes Publike, përcakton që për arsyetimin e transfereve/pagesave për projekte kapitale duhet të bashkëngjitet raporti i auditimit të brendshëm mbi rregullsinë e zbatimit të projektit për periudhën para bërjes së kërkesës nga NP.

Ministria kishte bërë 8 pagesa/transfere në vlerë totale 664,011€, për blerje të ndryshme për projektet “Hapja e vend punishteve të reja në horizontet X-XI” dhe “Riaftësimi i vend punishteve në horizontin IX-dhe VIII”, për të cilat nuk kishte raporte të bashkëngjitura të auditimit. Ministria nuk është siguruar paraprakisht së po respektohen kushtet e marrëveshjes, dhe pastaj të bëj transferimin e mjeteve. Kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës nga personat përgjegjës për të zbatuar kërkesat e marrëveshjes.

Rreziku Transferi i mjeteve për projekte kapitale në mungesë të raportit të auditimit të brendshëm rritë rrezikun që të kryhen pagesa pa sigurinë e duhur se zbatimi i projekteve është realizuar sipas dinamikës së paraparë.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të siguroj se monitorimi i marrëveshjes së arritur me Trepçën zbatohet në të gjitha dispozitat, dhe se asnjë transfer nuk do të bëhet para se të konfirmohet edhe me raportin e auditimit të brendshëm³.

Çështja B2 - Mos vlerësimi i efektshmërisë së drejtorëve të ndërmarrjeve publike

Gjetja Sipas Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike neni 28.3, Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP), në bazë vjetore duhet të vlerësoj efektshmërinë e drejtorëve të secilës Ndërmarrje Publike (NP) dhe këtë vlerësim të publikoj në faqen e saj zyrtare në internet. NJPMNP për të kryer këtë shërbim mund të angazhoj një ose me shumë këshilltar profesional ose kompani të këshillimit për të ndihmuar kryerjen e këtij vlerësimi.

NJPMNP në vitin 2018 nuk kishte arritur të bënte një vlerësim të tillë në mungesë të kapaciteteve. Kjo njësi kishte bërë kërkesë tek menaxhmenti për angazhimin e një kompanie të jashtme, por kjo kërkesë nuk ishte aprovuar me arsyetimin e mungesës së mjeteve buxhetore.

Rreziku Mungesa e vlerësimit të performancës së drejtorëve të ndërmarrjeve publike pamundëson nxjerrjen e konkluzioneve të aksionarit dhe grupeve të interesit nëse personat e ngarkuar me qeverisje të ndërmarrjeve publike kanë ushtruar aktivitetin e tyre në mënyrë profesionale, të përgjegjshme dhe efektive.

Rekomandimi B2 Ministri duhet siguroj se me rastin e planifikimit të kërkesave buxhetore të përfshihet edhe kërkesa për fonde buxhetore për angazhimin e këshilltarëve ose të ndonjë kompanie të këshillimit për të ndihmuar procesin e vlerësimit.

³ Ky rekomandim ka filluar të zbatohet në pjesën e fundit të vitit 2018.

Çështja B3 - Arsyetim i pamjaftueshëm i subvencioneve dhe raportim jo në pajtueshmëri me kërkesat ligjore

Gjetja Neni 6 i Marrëveshjes së monitorimit dhe kontrollit, të lidhur në mes Ministrisë dhe ndërmarrjes KRM Uniteti, përcakton që ndërmarrja të raportoj në baza tremujore dhe vjetore mbi shpenzimet e ndodhura.

Bazuar në këtë marrëveshje, Ministria ka bërë tri pagesa në vlerë totale 90,000€, për kryerjen e shërbimeve për minoritete dhe rastet sociale. Arsyetimi i shpenzimeve ishte bërë me disa fatura të naftës dhe lista të thjeshta me vendbanime ku jetojnë minoritetet, emra, mbiemra, dhe vlera mujore e ngarkesës financiare.

Dokumentacioni i sjellë nga kompania nuk ofron dëshmi të mjaftueshme se këta persona/përfitues janë klientë aktiv të kompanisë së regjistruar në sistemin e saj (përfshirë numrin identifikues, numrin e kuponit, faturimi dhe në përgjithësi historiku i borxheve). Për më tepër, kompania nuk kishte sjellë raporte të rregullta tre mujore, në lidhje me arsyetimin e shpenzimeve. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos vendosjes së kriterëve të qarta në marrëveshje rreth procesit të monitorimit, raportimit edhe arsyetimit të shpenzimeve.

Rreziku Mungesa e regjistrit adekuat të faturave të lëshuara mbi kryerjen e shërbimeve dhe mos raportimi të rregullt mbi mënyrën e shpenzimit të subvencioneve, rritë rrezikun që paraja publike të mos shfrytëzohet për qëllimin e duhur dhe të mos arrij objektivat e organizatës.

Rekomandimi B3 Ministri duhet të siguroj se në të gjitha marrëveshjet janë vendosur kriterë të qarta rreth procesit të monitorimit dhe raportimit, dhe se të njëjtat kriterë zbatohen në mënyrë rigoroze me rastin e transfereve të subvencioneve tek ndërmarrjet publike.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale për vitin 2018 ishte 9,138,183€, prej tyre ishin shpenzuar 8,366,386€ apo 92%. Ato kanë të bëjnë me masat mbi efikasitetin e energjisë në ndërtesat administrative e objektet arsimore, programi i zbatimit të ekonomisë digjitale, auditimi energjetik i ndërtesave publike dhe ndërmarrjeve dhe blerje për pajisje të teknologjisë informative.

Ne testuam edhe menaxhimin e proceseve në aspektin e pajtueshmërisë sa i përket menaxhimit të aktiviteteve në këtë kategori, dhe identifikuam këto çështje;

Çështja A6 – Lidhja e kontratave me zotim të pjesshëm

Gjetja Neni 36.1 i Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) përcakton se, para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, organizata buxhetore i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në SIMFK në përputhje me rregullat e kontrollit dhe menaxhimit financiar.

Ne kemi identifikuar në dy kontrata pune, zotimet e bëra para nënshkrimit të kontratave nuk ishin të plota. Për kontratën “Programi i zbatimit të Ekonomisë Digjitale - Shtrirja e Infrastrukturës Telekomunikuese Brez gjere”, në vlerë prej 218,000€, është bërë zotimi 167,418€, dhe për kontratën “Programi i zbatimit të masave të Eficiencës së Energjisë në objektet publike në nivel lokal për Arsim dhe Shëndetësi”, në vlerë 268,752€, është bërë zotimi 200,000€.

Kjo kishte ndodhur sepse ministria nuk kishte planifikuar alokime të mjeteve në tre mujorin e parë të vitit.

Rreziku Zotimi i pjesshëm para nënshkrimit të kontratave rrit rrezikun e hyrjes në obligime financiare dhe mundësinë që ministria t’u ekspozohet kontesteve gjyqësore në të ardhmen.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të siguroj që para nënshkrimit të kontratave, të zotohen fondet e duhura për mbulimin e obligimeve kontraktuese.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Ministria, në pasqyra financiare të vitit 2018 kishte prezantuar vlerën në libra të pasurive kapitale prej 14,308,000€, pasuria jo kapitale me një vlerë prej 67,000€ dhe stoqet në vlerë prej 65,000€.

Ne testuam edhe menaxhimin e proceseve në aspektin e pajtueshmërisë sa i përket menaxhimit të aktiviteteve në menaxhimin e pasurive jo financiare kapitale dhe jo kapitale, dhe identifikuam këto çështje:

Çështja A7 – Dobësi në procesin e inventarizimit vjetor të pasurive

Gjetja Sipas Rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, nenit 19 respektivisht paragrafit 4.1, është përgjegjësi e komisionit të inventarizimit që të bëhet inventarizimi i gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe kontrollë të organizatës buxhetore. Inventarizimit, në mes tjerash, duhet t’i paraprij një udhëzim i brendshëm sipas rregullores 02/2013 neni 19 pika 5.3.

Numërimi jo i plotë i gjithë pasurisë jo financiare vjen si rezultat i të kuptuarit të dobët të procesit të inventarizimit nga ana e komisionit, duke u fokusuar vetëm në numërimin e inventarit, por jo edhe të pasurive tjera. Pra, kjo ka ndodhur në mungesë të një udhëzimit të brendshëm për inventarizim dhe mungesës së kompetencës së komisionit për të kryer inventarizimin konform kërkesave ligjore.

Rreziku Mos inventarizimi i të gjithë pasurisë në pronësi të MZHE-së dhe mos harmonizimi me regjistrat e pasurisë, mund të ndikon në humbjen, përvetësimin e pasurisë dhe në prezantimin e drejt në PVF-të organizatës.

Rekomandimi A7 Ministri duhet që të siguroj se do të nxirret udhëzim i brendshëm dhe të emërojë zyrtar kompetent në komisionet për inventarizim në mënyrë që nga procesi i inventarizimit të konfirmohet ekzistenca fizike e pasurive dhe saktësia, dhe gjendja përfundimtare pasurive jo financiare të raportohet në PVF.

Çështja A8 - Regjistrim i gabuar i pasurive jo financiare kapitale në Sistemin E-Pasuria

Gjetja Sipas Rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, regjistri kontabël paraqet të dhënat në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK) për pasuritë që kanë vlerë mbi 1.000 € dhe afat të përdorimit më të gjatë se një vit.

Ministria ka blerë një kompjuter dhe pesë (5) laptop, në vlerë totale 12,583€. Vlera e tyre individuale është mbi 1000€ dhe afati i përdorimit mbi një vit. Këto pasuri nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël në SIMFK si pasuri kapitale, por ato janë regjistruar në sistemin E-pasuri. Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mos kompetencës dhe ndryshimit të shpeshtë të zyrtarit të pasurisë.

Rreziku Regjistrimi i gabuar i pasurisë kapitale në regjistrin e pasurisë jo kapitale paraqet nënvlerësim të pasurive kapitale dhe mbivlerësim të atyre jokapitale. Mos prezantimi i drejt i pasurive në PVF, rritë rrezikun e informacionit të gabuar të përdoruesve të PVF-ve.

Rekomandimi A8 Ministri duhet të siguroj që pozitën e zyrtarit për menaxhimin e pasurisë të mbulohet nga zyrtarët kompetent dhe të përgjegjshëm, dhe të siguroj trajnime adekuate profesionale në mënyrë që regjistrat e pasurisë të menaxhohen në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

3.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Ministria ka prezantuar në pasqyra financiare një avanc për udhëtim zyrtar në vlerë prej 580€ i cili ishte hapur me 21.12.2018 dhe një avanc për para të imët prej 2,500€ sipas vendimit të Qeveris nr. 04/82 të datës 28.12.2018 janë tërhequr të gjitha mjetet që ka në dispozicion ministria nga kategoria

e mallrave për qëllime të kursimit të përgjithshëm, dhe si rezultat avancet kanë mbetur të pa mbyllura.

3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 137,000€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Obligimet e papaguara për kategorinë mallra dhe shërbime ishin në vlerë prej 17,000 €, për karburante për vetura, mirëmbajtje të veturave, shërbime kontraktuese tjera dhe shpenzime të telefonisë mobile. Arsyet e mos kryerjes së pagesave sipas ministrisë ishte pranimi faturave me vonesë pas mbylljes së viti fiskal. Obligimet për kategorinë investime kapitale ishin në vlerë 119,000€, fatura nr 03/2018 ishte pranuar me datën 27.12.2018 për projektin kapitale *"programi i zbatimit të ekonomisë digjitale"*. Komisioni për pranim teknik të pajisjeve kishte vërejtje për disa pjesë dhe kishte kërkuar nga ministria zgjatjen e afatit për pagesë.

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerri veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Ministria kishte përmbushë kërkesën e MF lidhur me dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit.

Lidhur me aspektet strategjike, vlen të theksohet se edhe pse ministria ka hartuar planin strategjik zhvillimor për vitet 2017-2020 duke caktuar katër objektiva kryesore, atë nuk e ka azhurnuar për vitin 2018. Gjithashtu ka përcaktuar Prioritetet për vitin 2018, që nuk janë protokolluar. Programi për zbatimin e strategjisë minerare të Kosovës për periudhën 2015-2017, dhe Programi për zbatimin e strategjisë së energjisë 2018-2020, po ashtu, nuk janë azhurnuar.

Një numër i dobësive të qeverisjes brenda ministrisë u cekën më lartë në lidhje me moszbatimin e plotë të rekomandimeve nga vitet paraprake, po ashtu duhet shtuar kujdesin në proceset e prokurimit si dhe në subvencionet dhe transferet (përfshirë investimet kapitale) për entitete publike, ndërkaq sipas gjykimeve tona, auditimi i brendshëm ende nuk e ka pavarësinë e duhur të veprimit.

Ndër zhvillimet pozitive vlen të përmendet se ministria ka arritur të regjistroj dhe transferoj pasurinë investim në vijim në masë të konsiderueshme, përkundër gjetjeve të këtij viti, si dhe ka përmirësime në identifikimin dhe prezantimin e detyrimeve kontingjente.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor. Për të kryer një auditim efektiv, nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

NJAB kishte planifikuar dhe kishte kryeje gjithsej gjashtë (6) auditime për vitin 2018, komiteti i auditimit kishte shpjeguar se plani është realizuar vetëm 67% me arsyetimin se dy (2) raporte i kanë konsideruar si jo profesionale dhe që nuk plotësojnë standardet e auditimit.

Auditimi i Brendshëm nuk kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme, dhe rekomandimet e dhëna, nuk kanë kontribuar në përmirësimin e kontrollit menaxherial.

Çështja B4 - Dobësi në funksionimin e Auditimit të Brendshëm

Gjetja Sipas Ligjit nr. 03/L-128⁴ për Auditimin e Brendshëm nenit 14, paragrafi 2.8 Drejtori i NJAB duhet të dorëzoj planin vjetor dhe strategjik në NJQH dhe KA-së deri me 31 tetor të secilit vit. SNA 230, pika P3 (dokumentimi i auditimit) kërkon që dokumentimi i auditimit duhet të jetë i qartë në atë masë që një auditor tjetër me përvojë dhe i cili nuk ishte aktiv në atë auditim, të kuptoj qasjen e auditimit. Miratimi i planit vjetor dhe azhurnimi i planit strategjik është bërë me tre muaj vonesë.

⁴ Me datën 17.04.2018 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike. Me këtë rast është shfuqizuar Ligji nr. 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm.

- Realizimi i planit ishte i mangët nga gjithsej gjashte raporte ishin përfunduar vetëm katër apo 67%. Në pikën 3 të planit vjetor janë paraparë të kryhen auditime përgjatë vitit. Të gjitha raportet janë finalizuar në tremujorin e fundit të vitit 2018, dhe nga kjo arsye, nuk kanë ndihmuar shumë në përmirësimin e gjendjes me kohë në ministri;
- Procesi i komunikimit me departamentet nën auditim nuk ishte dokumentuar në raportet e auditimit, ku do mund të kuptohej nevoja për adresimin e rekomandimeve. Mungesat e stafit të auditimit për arsye shëndetësore dhe komunikimet e zgjata me menaxhmentin e MZHE-së për aprovimin e planit vjetor dhe strategjik, kanë vonuar proceset e planifikimit me kohë, si dhe finalizimin e raporteve deri në fund të vitit.

Rreziku Mos funksionimi i auditimit të brendshëm i pamundëson menaxhmentit posedimin me kohë të informatave rreth përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe sistemeve të kontrollit në relacion me kryerjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve të Ministrisë.

Rekomandimi B4 Ministri duhet të ndërmarrë veprime për siguruar burimet e mjaftueshme njerëzore për funksionimin e duhur dhe efektiv të auditimit të brendshëm, si dhe të aprovoj me kohë planet vjetore të punës për NJAB.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje, menaxhmentit ka nevojë të posedoj përveç raporte të rregullta dhe specifike, edhe të regjistroj procesverbalet ku do të mund të kuptohen përfundimet e nxjerra nga diskutimet dhe aktivitetet që do të ndërmerren. E gjithë kjo me qëllimin e vetëm që llogaridhënia si proces i pranimit të përgjegjësive, të jetë e qartë për personat përgjegjës lidhur me veprimet e tyre duke shpalosë rezultatet në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Çështja B5 – Dobësi në kontrollet menaxheriale

Gjetja

Ne kemi identifikuar se:

- Ministria posedon një listë të rreziqeve për vitin dhe ka bërë planin e veprimit, mirëpo veprimet e ndërmarra nuk kanë qenë të mjaftueshme për të zvogëluar ndikimet e këtyre rreziqeve. Disa nga këto mangësi vërtetohen edhe përmes gjetjeve të prezantuara në këtë raport..
- Me rastin e ekzaminimit të pajisjes Mikroskopi Skanuese Elektronik (SEM) me vlerë prej 498,987€ për laboratorin e Gjeologjisë së Kosovës, kemi vërejtë se kjo pasuri ishte blerë qe dy vite dhe nuk ishte vënë ende në funksion. Kjo gjendje ka ardhur në mungesës së hapësirave për ta vendosur pajisjen.

Rreziku

Mos mbajtja e procesverbaleve detale bënë që të mos kuptohet procesi i vërtet i zhvillimit të aktiviteteve operative dhe financiare. Mungesa e informatave të duhura nga menaxherët, vështirëson vendimmarrjen apo rritë rrezikun e vendimeve të gabuara të menaxhmentit të lartë, siç është rasti me blerjen e pajisjes para se të përgatiten hapësirat e duhura për vendosjen e saj.

Rekomandimi B5 Ministri duhet të siguroj se gjatë raportimeve të rregullta të mbahen procesverbale të detajuara dhe të dëshmohen veprimet e ndërmarra për reduktimin e rreziqeve para procesit të vendimmarrjes. Përveç tjerash, zgjidhja e problemit të pajisjes SEM duhet trajtuar me prioritet.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ka rezultuar në 14 rekomandime. Ministria kishte përgatitur planin e veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, tri (3) rekomandime janë zbatuar; tri (3) janë në proces të zbatimit, katër (4) rekomandime të pazbatuara dhe katër (4) rekomandime të mbyllura të pazbatuara. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni më poshtë tabelën e rekomandimeve.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PVF	Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes në Opinion. Për më tepër, të sigurohet menaxhim i mirë dhe kontrole adekuate në transferet kapitale për ndërmarrjet (publike) që ato të bëhen vetëm për projektet e aprovuara në Buxhet nga Kuvendi si dhe të ndërmerren veprime specifike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve, në veçanti investimet/transferet kapitale.	Nuk ka veprime që dëshmojnë përmirësimin	Rekomandim i pazbatuar
2	PVF	Ministri duhet të sigurojë se detyrimet kontingjente trajtohen dhe analizohen me kujdes dhe në koordinim me Avokaturën Shtetërore të sigurohen informata/dëshmi për përfaqësim adekuat të këtyre rasteve/lendeve. Po ashtu duhet bërë vlerësim të riskut të tyre dhe të sigurohen informata/shpalosje të mjaftueshme në PFV.	Në këtë vit iu janë kushtuar kujdes shpalosjes së detyrimeve kontingjente.	Rekomandim i zbatuar;
3	PVF	Ministri të ndërmarrë veprime për të siguruar kontrole efikase në procesin e investimeve dhe regjistrimin/raportimin e saktë të pasurive kapitale si dhe Pasqyrat Financiare Vjetore ti nënshtrohen rishikimit dhe vlerësimit rigoroz nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, para se deklarata të nënshkruhet dhe PFV-të të dorëzohen në MF.	Janë ndërmarr veprime në këtë vit dhe pjesë e konsiderueshme janë regjistruar	Rekomandim pjesërisht i zbatuara;
4	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të ndërmerr veprime që të rrisë kontrollet lidhur me kontratat me qëllim që të siguroj se shpenzimi i parasë bëhet përmes kontratave të bazuara dhe me mbështetje ligjore.	Nuk janë lidhur kontrata të reja me procedura të prokurimit	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
5	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të rrisë kontrollet për menaxhim të mirë të kontratave për shpenzime udhëtimi, po ashtu të siguroj	Nuk janë ndërmarr veprime për	Rekomandim i pazbatuar i mbyllur.

		një planifikim sipas nevojave reale dhe të arsyeshme, që shpenzimet e bëra për udhëtime të jenë në pajtim me arritjen e objektivave të ministrisë.	përmirësim të gjendjes.	
6	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të rrisë kontrollet në këtë fushë dhe të siguroj se shpenzimet për udhëtime zyrtare bëhen në bazë të rregullave të përcaktuar dhe realizohen vetëm për qëllimet e duhura të ministrisë. Po ashtu të analizoj udhëtimet e ndodhura pa arsyeshmëri të mjaftueshme dhe të siguroj se praktika të tilla të mos përsëriten.	Nuk janë ndërmarr veprime por nuk ka raste tipike të reja.	Rekomandim i pa zbatuar i mbyllur.
7	Subvencione dhe transfere	Ministri duhet të siguroj monitorim adekuat mbi ndërmarrjet publike, menaxhim dhe kontroll të duhur për shpenzimet e subvencioneve, duke përcaktuar kritere të qarta për mënyrën e raportimit lidhur me këto shpenzime.	Nuk janë ndërmarr veprime	Rekomandim i pazbatuar.
8	Subvencione dhe transfere	Ministri duhet të siguroj kontrole të duhura rreth monitorimit të subvencioneve, të kërkojë nga zyrtaret përgjegjës që të bëjnë një ekzaminim të dokumentacionit dhe subvencionet të jepen pasi të sigurohen se ato i shërbejnë qëllimit të synuar.	Nuk janë ndërmarr veprime	Rekomandim i pazbatuar.
9	Subvencione dhe transfere	Ministri duhet të siguroj monitorim efektiv për transferet kapitale për projektet në ndërmarrjet publike, me qëllim që ato të shpenzohen në përputhje me aprovimin e tyre. Po ashtu, të sigurohet se tranferet e mjeteve bëhen vetëm pas procedurave korrekte të blerjeve dhe bartjes së pronësisë së pasurisë.	Janë ndërmarr veprimet e nevojshme	Rekomandim i zbatuar
10	Çështje e përbashkëta	Ministri duhet të siguroj kontrole dhe menaxhim adekuat në fushën e prokurimit duke siguruar procedura adekuate të prokurimeve/kontraktimeve.	Nuk janë identifikuar në këtë vit raste të ngjashme	Rekomandim i pazbatuar i mbyllur.

11	Çështje e përbashkët	Ministri duhet të siguroj kontrolle të duhura në fushën e prokurimit dhe menaxhim adekuat të kontratave publike me qëllim të realizimit korrekt të tyre dhe arritjes së vlerës për para.	Nuk janë identifikuar në këtë vit raste të ngjashme	Rekomandim i pazbatuar i mbyllur.
12	Progresi i zbatimit të rekomandimeve	Ministri duhet të analizoj arsyet e moszbatimit të rekomandimeve paraprake dhe siguroj se plani i veprimit i rishikuar i adreson të gjitha dobësitë dhe i nënshtrohet monitorimit të rregullt nga menaxhmenti.	Janë ndërmarr veprime por jo të mjaftueshme	Rekomandim i pazbatuar i mbyllur.
13	Auditimi i brendshëm	Ministri duhet të merr masa të menjëhershme që të siguroj funksionimin efektiv të NJAB me qëllim që përfatimet nga kjo njësi të jenë maksimale duke kontribuar në funksionimin e duhur të kontrolleve të brendshme.	Nuk janë ndërmarr veprime	Rekomandim i pazbatuar.
14	Kontrollet menaxheriale	Ministri duhet të sigurojë veprime konkrete për përmirësimin e pikave të dobëta në kudër të vet-vlerësimit, të siguroj se të gjitha pagesat për projekte kanë arritur qëllimin e duhur dhe të siguroj se blerja e pajisjeve bëhet në bazë të planeve/nevojave të ministrisë, duke siguruar fillimisht lokacion/objekt.	Janë ndërmarr veprime por jo të mjaftueshme	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PVF	Rekomandimi B1 Ministri duhet të ndërmerr veprime për t'i forcuar kontrollet parandaluese në mënyrë që të shmangen rastet për Theksim të Çështjes në Opinion. Ne rekomandojmë që qysh në fazën e planifikimeve buxhetore, projektet të buxhetohen sipas kategorive ekonomike dhe klasifikimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë nëpër kodet adekuate.		
2	PVF	Rekomandimi C1 Ministri duhet të siguroj funksionimin adekuat dhe sistematik të kontrollit lidhur me plotësinë e regjistrave të pasurisë duke siguruar se Pasqyrat Financiare Vjetore do të nënshtrohen rishikimit dhe vlerësimit rigoroz nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, para se deklarata të nënshkruhet dhe PFV të dorëzohen në Ministrinë e Financave.		

3	Paga dhe Meditje	Rekomandimi A1 Ministri duhet që të shqyrtoj arsyet e mosvijimit në punë të këtyre punëtorëve, të zgjidhë problemin e angazhimit të tyre të rregullt në punë, ose në të kundërtën, të ndërpres pagesat e pagave të tyre të parregullta. e Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, ministri rekomandohet çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri.
4	Mallra dhe shërbime	Rekomandimi A2 Ministri duhet të veprojë në pajtim me obligimet e tyre ndaj kontratave të AQP-së, me qëllim të ekonomizimit të shpenzimeve dhe rritjes së vlerës për para.
5	Mallra dhe shërbime	Rekomandimi A3 Ministri duhet të siguroj respektimin e rregullave në fuqi që shpenzimet për udhëtime zyrtare të bëhet vetëm për qëllime zyrtare dhe që për shpenzimet e pa rregullta të bëhet kthimi i mjeteve në buxhetin e ministrisë..
6	Mallra dhe shërbime	Rekomandimi A4 Ministri duhet të siguroj se zyrtarët e prokurimit janë plotësisht përgjegjës dhe kompetent në punën e tyre, dhe se të gjitha blerjet bëhen në pajtim me procedurat kontratat të lidhen në bazë të legjislacionit në fuqi, duke synuar për të siguruar furnizime adekuate me çmime sa më konkurruese. dhe transparencë të plotë mbi shfrytëzimin e fondeve publike.
7	Subvencione dhe Transfere	Rekomandimi A5 Ministri duhet të siguroj se monitorimi i marrëveshjes së arritur me çdo pagesë e bërë për Trepçën zbatohet në të gjitha dispozitat, dhe se asnjë transfer nuk do të bëhet para se të konfirmohet edhe me të këtë raportin e auditimit të brendshëm. mbi rregullsinë e implementimit të projektit të përcaktuar në marrëveshje, me qëllim të shfrytëzimit të drejtë të parasë publike.
8	Subvencione dhe Transfere	Rekomandimi B2 Ministri duhet siguroj se me rastin e planifikimit të kërkesave buxhetore të përfshihet edhe kërkesa /nevojat për fonde buxhetore për rreth angazhimint e të kompanive/këshilltarëve ose të ndonjë kompanie të këshillimit për të ndihmuar procesin e vlerësimit. që do të bënin vlerësimin e performancë së drejtorëve të ndërmarrjeve publike..
9	Subvencione dhe Transfere	Rekomandimi B3 Ministri duhet të siguroj se në të gjitha marrëveshjet janë vendosur kritere të qarta rreth procesit të monitorimit dhe raportimit, dhe se të njëjtat kritere zbatohen në mënyrë rigoroze me rastin e transfereve të subvencioneve tek ndërmarrjet publike që të arrihet një menaxhim efektive dhe transparente i shpenzimin e parës publike.
10	Investime kapitale	Rekomandimi A6 Ministri duhet të siguroj që para nënshkrimit të kontratave, të zotohen fondet e duhura për mbulimin e obligimeve kontraktuese. Për projektet kapitale të bëhet planifikimi i përshtatshëm i

		rrjedhës së parasë/alokimeve dhe se para nënshkrimit të kontratës të bëhet zotimi i plotë i mjeteve.
11	Pasuri	Rekomandimi A7 Ministri duhet që të siguroj se do të nxirret udhëzim i brendshëm dhe të emërojë zyrtar kompetente në komisioneti për inventarizimit në mënyrëe qëe nga procesi i inventarizimit të konfirmohet ekzistenca fizike e pasurive dhe saktësia, dhe gjendja përfundimtare jepen informata të plota ne lidhje me saktësinë, cilësinë dhe gjendjen fizike të pasurive jo financiare të raportohet në PFV. që janë në pronësi dhe kontroll të Ministrisë.
12	Pasuri	Rekomandimi A8 Ministri duhet të siguroj që pozitën e zyrtarit për menaxhimin e pasurisë të mbulohet nga zyrtaret kompetente dhe të përgjegjshëm, dhe të siguroi trajnime adekuate profesionale në mënyrë që regjistrat e pasurisë të menaxhohen në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.
13	Sistemi i Auditimit Brendshëm	Rekomandimi B4 Ministri duhet të ndërmerrë veprime për siguroar burimet e mjaftueshme njerëzore për funksionimin e duhur dhe efektive të auditimit të brendshëm, si dhe të aprovoj me kohë planet vjetore të punës për NJAB me qëllim të kontribohet në përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiare dhe të kontrolleve të brendshme.
14	Raportim i menaxherial	Rekomandimi B5 Ministri duhet të siguroj se gjatë raportimeve të rregullta të mbahen procesverbale të detajuara dhe të dëshmohen veprimet e ndërmarra për reduktimin e rreziqeve para procesit të vendimmarrjes. menaxhimin e rrezikut Përveç tjerash, zgjidhja e problemit të pajisjes SEM duhet trajtuar me prioritet.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Komentet e MZHE-së në gjetjet e raportit të auditimit

Gjetjet/ çështjet	Pajto hemi po/jo	Komentet e MZHE-së në rast të mospajtimit	Pikëpamjet e ZKA-së
Theksimi i çështjes.	Jo	<p>Ne shprehim mos pajtimin lidhur me konstatimin për projektin "Sistemi i Integruar Informativ për Zhvillimin Ekonomik të Kosovës" (SIZHEEK), për faktin se ne kemi bere zbatimin e vendimeve të Qeverisë për SIZHEEK duke iniciuar projektin për ofrimin e shërbimeve profesionale intelektuale për hartimin e SIZHEEK dhe jo projekt për furnizim me pajisjeve hardverike dhe softverike. Nga kjo munde të konstatohet se iniciimi i projekti nuk ka qen i kualifikuar si softver por si shërbime inteligjente për ti standardizuar të dhënat ne një platforme të vetme duke i përdor kapacitete hardverike dhe softverike te institucione përkatës me qellim edhe ekonomizimi dhe lehtësim të ndërthurjes ne sistem. Pas finalizimit te projektit dhe rezultatit të arritur divizioni i buxhetit ka bere regjistrimin si pasur kapitale ne SIMFK duke qen të vetëdijshëm ne kategorizim të investimit meqenëse efektet e këtij projekti kanë rezultuar me ndikim kapitalizmi pas investimit.</p>	<p>Ministria është duke zhvilluar web aplikacion i quajtur SIIZHEK gjithashtu mirëmbajtja e këtij sistemi do te jetë 2 vite pas përfundimit të projektit prandaj nëse do të ishte shërbim nuk do të kishte mirëmbajtje. Webaplikacioni është regjistruar në regjistrin kontabël të pasurisë. Në mungesë të dëshmime shtesë dhe justifikimeve të pabaza, gjetja dhe rekomandimi mbeten apo nuk ndyshohen.</p>
Çështja A1 – Kompensim për punëtorët që nuk kanë punuar.	Pjesër isht	<p>Nëpunësit civil të integruar në MZHE si obligim i adresuar nga Marrëveshja e Brukselit dhe vendimit të Qeverise me nr 06/39 i datës 22.07.2015 ka qene i paraparë të jetë në objekt të Qeverisë në pjesën e Mitrovicës së Veriut.</p> <p>MZHE-ja, ka siguruar inventarin dhe ka përgatit kushtet për punë në objektin e ri të Qeverisë përmes MAP në pjesën Veriore, ka siguruar tavolinë pune dhe kompjuter personal për secilin nëpunës dhe nëpërmes koordinatorit Defrim Shala ka thirrur stafin e integruar na takime për udhëzimet e nevojshme qe të filloj punën në baza ditore, te cilët kanë qene të</p>	

		<p>gatshëm që të paraqiten në punë dhe të realizojnë detyrat në bazë ditore.</p> <p>Mirëpo, një ditë pas inaugurimit të objektit qeveritar në Mitrovicën e Veriut objekti është demoluar me eksploziv.</p> <p>MAP-i është përgjegjëse për renovim të objektit, e që sipas njoftimeve të MAP funksionalizimi i objektit ende nuk është i gatshëm për punë. Duhet cekur se janë organizuar edhe takime trajnimi me qëllim njoftimin edhe të legjislacionit përkatës të shërbyesve civile dhe ligjet tjerat në fuqi.</p> <p>Për me shume detaje gjeni të bashkëngjitur raportin e përgatitur nga z. Shala për çështjen e të punësuarve të integruar nga mbrojtja civile- për vlerësimin e punës për vitin 2018.</p>	<p>Me sigurimin e kushteve të punës në veri është përgjegjëse Ministria e Aministratës Publike (MAP) dhe jo MZHE sido që të jetë në jemi siguruar se këta punëtor nuk kanë punuar asnjëherë prandaj edhe kemi konsideruar se pagesa është pa vijueshmëri në punë. Ajo çfarë pohon MZHE paraqet vetëm shkakun, Në mungesë të dëshmimeve shtesë dhe justifikimeve të pabaza, gjetja dhe rekomandimi mbeten apo nuk ndyshohen.</p>
<p>Çështja A2: Mos shfrytëzimi i kontratës së Autoritetit Qendror të Prokurimit.</p>	jo	<p>Kontrata e AQP-se është kontratë për shërbim, jo për furnizim sepse të gjitha pajisjet janë me qira. Në kuadër të kontratës së AQP-së në specifikacion teknik nuk ka skaner dhe toner (Faqe 21 deri në 23 të kontratës së AQP-se), prandaj e gjetura nuk qëndron pasi që nuk janë skanerët dhe tonerët pjesë e specifikacioni të kësaj kontrate që është në webfaqen e AQP-se. Prandaj kemi qen të obliguar që të furnizohemi me pajisjet e skanimit profesional për nevojat e MZHE-së.</p> <p>Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil neni 35 parasheh përkrahjen në ngritje profesionale të zyrtarëve.</p>	<p>Skanerët dhe tonerët janë blere për të kryer shërbimet për të cilat është kontrata e AQP-së. Në kontratën e AQP-së në nenin 1, paragrafi 1.1 specifikohet llojet e shërbimeve që mbulon kontrata përfshi edhe skanimin dhe tonerët, Në mungesë të dëshmimeve shtesë dhe justifikimeve të pabaza, gjetja dhe rekomandimi mbeten apo nuk ndyshohen.</p>

<p>Çështja A3: Pagesë e udhëtimit për qëllime jo zyrtare.</p>	<p>jo</p>	<p>Bazuar ne Ligjin për Shërbimin Civil neni 35 parasheh përkrahjen në ngritje profesionale te zyrtareve.</p>	<p>Neni 35 i ligjit për shërbyes civil parasheh trajnimin e stafit për shërbime profesionale ndërsa zyrtarës në fjalë i janë hequr shpenzimet e udhëtimit për mbrojtje të temës së Masterit jashtë vendit dhe kjo nuk paraqet trajnim profesional por shkencor. Në mungesë të dëshmime shtesë dhe justifikimeve të pabaza, gjetja dhe rekomandimi mbeten apo nuk ndyshohen.</p>
<p>Çështja A4: Furnizim jashtë kontratës bazë.</p>	<p>jo</p>	<p>Furnizimi është bere duke u mbështet në kontratën bazë dhe nenin 35 par 2.2. të LPP-së në kontrate për furnizim, si ne vijim: Për dërgesa shtesë nga furnizuesit fillestar kur dërgesat e tilla shtesë janë zëvendësime për produktet ose instalimet e dërguara ose kur përbëjnë një zgjatje të dërgesave aktuale të produkteve ose instalimeve nëse ndryshimi i furnizuesit domosdo kërkon nga autoriteti kontraktues që të pranojë produktet ose instalimet që kanë karakteristika të ndryshme teknike ose karakteristika të tjera që janë materialisht të ndryshme nga produktet ose instalimet që janë blerë më parë, dhe këto ndryshime do të rezultojnë në mospërputhshmëri apo vështirësi teknike të jashtëzakonshme në funksionim dhe mirëmbajtje. Më kusht që, sidoqoftë, ky nen 35.2.2(i) i LPP-së të mund të përdoret vetëm për të mbuluar një ose më shumë kontrata për dërgesa shtesë që vetëm, ose së bashku, e kanë një vlerë që nuk është më e madhe se 10% e vlerës së kontratës që mbulonte dërgesat fillestare.</p>	<p>Blerjet e bëra nuk janë furnizime shtesë apo zëvendësime për pozicionet e kontratës bazë, "Furnizimi me pajisje të teknologjisë së informacionit për shkolla të mesme Qendra – Kreative" ato janë krejtësisht furnizime të reja për nevojat e Ministrisë. Në mungesë të dëshmime shtesë dhe justifikimeve të pabaza, gjetja dhe rekomandimi mbeten apo nuk ndyshohen.</p>

		Ne këtë rast ne kemi furnizuar skaner dhe toner me aneks kontratë që skanerët janë pajisje të IT-se kurse tonerë janë material që përdoren për pajisje të IT-se, por asnjë here nuk ka ndodhe të tejkalohet përqindja e cekur në ligj prej 10% kushti kryesor i nenit.	
Çështja A6: Lidhja e kontratave me zotim të pjesshëm.	jo	<p>Kjo çështje nuk qëndron për arsye sepse zotimi i mjeteve ka qene i paraparë për vitin 2018 dhe i siguruar, auditori është mbështet në kërkesën për mallra dhe shërbime të datës 06.04.2018, andaj sqarimet si në vijim:</p> <p>1. Çdo kontratë nënshkruhet duke u mbështet në nenin 9 të LPP-se paragrafi 2. citat: Nëse pas vlerësimit të nevojave, ZKA vendos se vlerësimi i nevojave e arsyeton ushtrimin e aktivitetit të prokurimit, ZKA i dërgon një kopje të këtij vlerësimi ZKF të autoritetit kontraktues. ZKF siguron se ka mjete financiare në dispozicion për prokurimin përkatës. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore, ZKF në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publik dhe Përgjegjësitë dhe Rregullat Financiare do të sigurojë nëse janë ndarë mjete të mjaftueshme financiare për prokurimin përkatës në shumë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve që mund të dalin si rezultat i prokurimit në fjalë gjatë vitit aktual fiskal.</p> <p>Këto procedura të prokurimit kanë qene planifikuara në kuartale përkatëse sipas alokimit të fondeve në planin e rrjedhës së parasë, kështu që nuk ka pas mundësi të ndodhe ndonjë kontest gjyqësor për pagesa, dhe kanë qene në tabelat të aprovimit të Buxhetit për vitin 2018.</p>	<p>Kontratat janë nënshkruar për dy llojet:</p> <p>a) “Programi i zbatimit të Ekonomisë Digjitale - Shtrirja e Infrastrukturës Telekomunikuese Brez gjere”, në vlerë prej 218,000€, është bërë zotimi 167,418€.</p> <p>b) “Programi i zbatimit të masave të Eficiencës së Energjisë në objektet publike në nivel lokal për Arsim dhe Shëndetësi”, në vlerë 268,752€, është bërë zotimi 200,000€. Të dy projektet janë prapa të përfundohen brenda vitit 2018. Zotimi është dasht të jetë i barabart me vlerën në kontrata. Në mungesë të dëshmimeve shtesë dhe justifikimeve të pabaza, gjetja dhe rekomandimi mbeten apo nuk ndyshohen.</p>

<p>Çështja B5: Dobësi në kontrollet menaxheriale.</p>	<p>Jo/po</p>	<p>Edhe sipas vetë konstatimit nga ekipi për takimet e stafit, ne baza javore janë të natyrës menaxheriale, mbikëqyrëse raportuese ne përmbushje të planifikimeve atëherë raportet javore, mujore dhe tremujore janë rezultat i vet aktiviteteve dhe nuk ka asnjë dispozite ligjore e cila e përcakton obligimin për mbajtje të minutave të takimeve të rregullta të stafit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Menaxhementi që nga viti 2016 harton ne bashkëpunim me udhëheqësit e të gjitha njësive listën e rreziqeve për vitin ne vijim. E gjithë kjo bazuar ne rekomandimin e ZKA-se te vitit 2016. Kjo mbështetur edhe ne objektivat e punës se Ministrisë, Objektivat e KASH-it, etj. Po ashtu hartohet edhe plani i zbatimit te rrisqeve, ne këtë kuptim edhe këto dy dokumente janë te pashmangshme ne te gjitha aktivitet menaxheriale mbikëqyrëse gjate gjithë vitit ne vijim dhe nuk ka asnjë standard te bazuar ne dispozita se si kjo duhet te këtë ndërlidhje faktike nga ajo qe është konstatuar ne këtë pike. <p>Sa i përket mosvënies ne funksion të mikroskopit SEM është e vërtet se ende Shërbimin Gjeologjik nuk ka arritur qe te gjej objektin me hapësirën e parapare sipas specifikave teknike te vete mikroskopit. Vënja ne funksion e mikroskopit duke mos qene ne hapësirat adekuate rrezikon dëmtimin e tij sipas udhëzimeve te prodhuesit. Përtej përpjekjeve te vazhdueshme nga Menaxhementi i Ministrisë, MAP si Ministri përgjegjëse ende nuk ka arritur qe te siguroj objektin me hapësira adekuate.</p>	<p>Në mungesë të dëshmive shtesë dhe justifikimeve të pabaza, gjetja dhe rekomandimi mbeten apo nuk ndyshohen.</p>
---	--------------	--	--